

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 23 /2025

Datë: 22/01 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), në pajtim me nenin 58 (paragrafi 6) të Ligjit nr. 06/L-010 të Ligjit për Noterinë dhe nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-272 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, si dhe në përputhje me neni 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34, 18 Nëntor 2022), si dhe në pajtim Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 436/2024, të datës 17.12.2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.1 e Vendimit Nr. 436/2024, të datës 17.12.2024, si në vijim:

1.1 *Drilon Dobruna, Zyrtar Administrativ në Odën e Noterëve, Kryesues.*


2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Albulena HAXHIU
Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Z. Drilon Dobruna;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ministres;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Odes së Noterëve të Kosovës;
- Gjykatës Themelore në Prizren;
- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 436/2024

Datë: 17/12.2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të ta pavarura, në pajtim me nenin 58 (paragrafi 6) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë dhe nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjin nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Komisioni për pranimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara në Zyrën e Noterit Besim (Shani) Luli në Komunën e Prizrenit dhe dorëzimin e tyre në Gjykatën Themelore në Prizren, në këtë përbërje:

- 1.1. Arber Shabani, Udhëheqës i Shërbimit Administrativ në Odën e Noterëve, Kryesues;
- 1.1. Teuta Hoxha, Zyrtare e Lartë në Divizionin për Mbikëqyrjen e Noterëve, anëtare;
- 1.3. Irfan Dorambari, Arkivist në Gjykatën Themelore në Prizren, anëtar.

2. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, mban procesverbal për pranim-dorëzimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara.

3. Komisioni fillon punën nga dita pasuese e pranimit të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Albulena Haxhiu

Ministër e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Noterit, z. Besim Luli;
- Odës së Noterëve Kosovës;
- Gjykatës Themelore në Prizren;
- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivot të Ministrisë së Drejtësisë.